



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 35, datë 12.05.2020

**PËR  
MIRATIMIN E PRISHJES SË DETYRUAR TË GODINËS SË SHKOLLËS CIKLI  
ULËT, PERLAT, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH, DURRËS, REKOMANDUAR  
NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, TIRANË, SI DHE HEQJEN NGA KONTABILITETI  
DHE LISTA PARAPRAKE E PRONAVE TË KËSAJ GODINE**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 297, datë 28.04.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Sukth, të Qarkut Durrës”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr.887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.940 prot., datë 30.04.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, me lëndë “Dërgim Akt ekspertizë”, ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,



**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**


1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës së shkollës Cikli Ulët Perlat, që mban nr. 14, të listës së transferimit, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave paluajtshme të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019, riparimi nuk bëhet, dhe rekomandohet të demolohet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për hoqjen nga lista paraprake e pronave të Njësisë Administrative Sukth, Bashkia Durrës, të pronës me nr. 14, me vendodhje në Perlat, Njësia Administrative Sukth, që i përket shkollës Cikli Ulët Perlat, që me VKM nr. 297, datë 28.4.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Njësia Administrative Sukth, që në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me nr.14, me vendodhje Perlat, Sukth, Njësia Administrative Sukth, që i përket shkollës Cikli Ulët Perlat, që me VKM nr. 297, datë 28.04.2010, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Sukth (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimit, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, që bazuar në Aktin Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkëpunojnë punën me Njësinë Zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e godinës së shkollës Cikli Ulët Perlat, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të godinës, pas realizimit të rindërtimit.




7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme Ligjore.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 12.05.2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 427 Prot.  
3

Durrës, më 13.05.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS ✓

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 35, datë 12.05.2020 “Për miratimin e prishjes së detyruar të godinës së shkollës Cikli Ulët, Perlat, njësia administrative Sukth, Durrës, rekomanduar nga Instituti i Ndërtimit, Tiranë, si dhe heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake e pronave të kësaj godine”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

